# DËSHMI ARKIVI

**A-462948**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Cili shtet e përdor më shumë ChatGPT në Ballkan? Shqipëria renditet e parafundit |
| ADRESA | `https://newsbomb.al/aktualitet/cili-shtet-e-perdor-me-shume-chatgpt-ne-ballkan-shqiperia-renditet-e--i401870` |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:54:38 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 05:53:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ea189c8f600e7d7258e5165643b434e6c43632193935a34a8d895c9502ca66fd` |
| TEKSTI | `34c3105160afa5de573deb719b6c962e77f46255d4d75bac7a426559eb93fe7e` |
| PAMJA | `980de4bf7ae8f0a2c443bbdbe2906e100a62873bbe6faa8cd60ab22babbe7d1d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `fd179f430f1afe20922e327358bd35256c0fc2471d72b99a4b786325348d0f74` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/fd179f430f1afe20922e327358bd35256c0fc2471d72b99a4b786325348d0f74`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



Aktualitet

23 Shtator 2026, 07:53

# Cili shtet e përdor më shumë ChatGPT në Ballkan? Shqipëria renditet e parafundit

Shkruar nga Newsbomb




Foto ilustruese

Përdorimi i inteligjencës artificiale po rritet me shpejtësi në të gjithë botën, por ritmi i përhapjes mbetet shumë i pabarabartë mes vendeve.

Në Ballkanin Perëndimor, Serbia kryeson për përdorimin e ChatGPT, ndërsa Shqipëria renditet pranë fundit të rajonit, sipas të dhënave të publikuara nga Banka Botërore.

Në maj 2025, Serbia regjistroi 231 vizita në ChatGPT për çdo 100 përdorues interneti, niveli më i lartë ndër vendet e Ballkanit Perëndimor të përfshira në krahasim.

Pas saj renditej Maqedonia e Veriut, me 166 vizita për 100 përdorues interneti, ndërsa, Mali i Zi, kishte 146 vizita.

Shqipëria regjistroi 142 vizita për 100 përdorues interneti, duke lënë pas vetëm Bosnjë-Hercegovinën, me 134 vizita.

Krahasuar me disa ekonomi të zhvilluara, përdorimi i ChatGPT në rajon mbetet më i ulët. Gjermania regjistronte 274 vizita për 100 përdorues interneti, Franca 262, Spanja 254 dhe Suedia 351. Në Australi treguesi arrinte në 447 vizita, ndërsa në SHBA në 245.

Dallimet në përdorimin e iA-së kanë rëndësi edhe për ekonominë. Banka Botërore e konsideron inteligjencën artificiale një teknologji transformuese, me potencial për të rritur produktivitetin, për të përshpejtuar rritjen ekonomike dhe për të ndryshuar mënyrën se si organizohet puna dhe ofrohen shërbimet.

Revista




Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit



Bota
Rusia godet qendrat e të dhënave në Kiev, ndërpritet interneti për 100 mijë familje



Politikë
"Shteti i gysrave!" Salianji "shpërthen" pas arrestimit të shefes së SHISH: Qeveria e Ramës ka ulur pantollonat para krimit (REAGMI)

Zbulo më shumë artikuj

Përdorimi i iA-së mund të ulë kohën dhe koston e kryerjes së një sërë procesesh, të ndihmojë bizneset në automatizimin e detyrave dhe analizën e të dhënave dhe të rrisë produktivitetin e punonjësve. Ndikimi pritet të shtrihet në sektorë të ndryshëm, nga arsimi dhe shërbimet te bujqësia dhe aktivitetet profesionale.

Për ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, ku produktiviteti dhe konkurrueshmëria mbeten sfida afatgjata, përhapja më e shpejtë e teknologjive të iA-së mund të ndikojë edhe në aftësinë e bizneseve për të konkurruar me kompanitë e vendeve më të zhvilluara.

Por Banka Botërore paralajmëron se përfitimet nga iA-ja nuk shpërndahen automatikisht. Vendet që kanë infrastrukturë dixhitale më të dobët, më pak aftësi teknologjike dhe kapacitete më të kufizuara llogaritëse rrezikojnë të mbeten pas ekonomive që e përvetësojnë teknologjinë më shpejt.

Kostoja e aksesit në internet mbetet një nga pengesat kryesore në ekonomitë më të varfra. Sipas Bankës Botërore, në vendet me të ardhura të ulëta një paketë celulare prej 5 GB mund të kushtojë më shumë se 15% të buxhetit mesatar të një personi./**Monitor**




## Sondazh

Poll

## Lexo gjithashtu




E Mërkurë 20:27 Newsbomb

## GJKKO e do në burg për trafikimin e

## GJKKO e do në burg për trafikimin e dhjetërave ton kokainë, PRANGOSET në Rusi i shumëkërkuari Shpëtim Aliu, "shoku" i Eldi Dizdarit pritet t'i dorëzohet Shqipërisë (DETAJE)



Aktualitet

Kryeqyteti pret të dielën "Triathlon", në fundjavë do të ketë bllokime rrugësh, ja cilat zona do të "paralizohen"

E Mërkurë 19:54



Aktualitet

Aksident i dytë brenda ditës në Durrës, makina përplas qytetarin me skuter elektrik

E Mërkurë 19:14




E Mërkurë 18:39 Newsbomb

## Duraj tha se Bleona Mata është gjallë, nëna "e helmuar" nga deklarata e tij e paralajmëron: Do të ndjek penalisht! Reagon dhe SPAK




Aktualitet

KED lejon tre kandidatë të vazhdojë garën për Gjykatën Kushtetuese, ndalohet vetëm Brunilda Bara

E Mërkurë 17:52



Aktualitet

Parkimi në rrugët e Durrës bëhet me lekë, ja sa do të paguajnë qytetarët

E Mërkurë 17:45






E Mërkurë 17:35 Newsbomb

## E RËNDË në Dibër, efektivi i Policisë ndalohet për dhunë fizike ndaj një vajze dhe vëllait të saj të mitur (DETAJE)



Aktualitet

Behgjet Pacolli publikon FOTO me dy miqtë e tij nga Nju Jorku, por puna që ata bëjnë mund ta ndihmojë shumë për Aeroportin e Vlorës

E Mërkurë 17:07



Aktualitet

SPAK zbardh kërkesën: Shefja e SHISH do të merret në pyetje mesditën e nesërme, dy të tjerët në orën 9 të mëngjesit (DETAJE)

E Mërkurë 16:44 Newsbomb




E Mërkurë 15:49 Newsbomb

## Sërish zjarr në Vlorë, vatra e tretë për sot, rrezikohet spitali i qytetit dhe banesat, detajet e para



Aktualitet

Nesër seancë plenare, mobilizohen studentët! Paralajmërojnë protestë para Parlamentit, ja “porosia” që i lënë njëri-tjetrit

E Mërkurë 15:29



Aktualitet

Ky është 50-vjeçari që humbi kontrollin e motorit, u rrëzua dhe vdiq në Lezhë, la pas gruan, dy djem e dy vajza (EMRI-FOTO)

E Mërkurë 15:30 Newsbomb




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.